

## Vllaznia/ Arrestohet Olsi Gocaj

nga AlbaniaSoccer

E premte, 01 Nentor 2013 22:17

---



Lojtari i Vllaznise Olsi Gocaj eshte ndaluar nga policia. Nje aksident automobilistik i ka prishur planet futbollistit kuqeblu qe mendonte te luante te dielen ndaj Bylisit. Gocaj te enjten ka perplasur nje kalimtar duke u kthyer me makine per ne shtepi. I demtuari fatmiresisht eshte jashte rrezikut per jeten nderkohe qe Gocaj eshte ndaluar nga policia dhe vetem pasi te behet seanca gjyqesore do te percaktohet masa per te.